Aleksandar (Rodoljub) Savić

(21.10.1974, serb nga Çaçaku, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Borisi punonte në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë nga muaji dhjetor i vitit 1995. Punonte në Shërbimin e Sigurimit Shtetëror. Aleksandri jetonte në Çaçak. Pas përfundimit të kursit për oficer policie, në shkurt të vitit 1997, ai u punësua në stacionin policor në Çaçak. Aleksandri për herë të parë shkoi në Kosovë në muajin mars të vitit 1998.

Në datën **16.09.1998,** rreth orës 15:30, Borisi dhe Aleksandri gjendeshin në patrullë në *Mëhallën Huseinoviq* në **Stantërg/ Stari Trg**, kur pjesëtarët e UÇK-së hapën zjarr ndaj tyre. Borisi, Aleksandri dhe katër policë të tjerë u plagosën. Aleksandri ndërroi jetë më 17.09.1998, kurse Borisi më 23.09.1998 në AMU. Familjarët e varrosën Aleksandrin më 19.09.1998 në varrezat e qytetit në Çaçak. Boris Plahuta u varros më 23.09.1998 në Peruqac [Bajina Bashta].

Burimet: deklarata R.S, FDH-31211; KKMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički..*, III, 490; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 54, 61.

Januz (Deli) Shala

(1914, shqiptar nga Vidishiqi/Vidušić, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, tetë fëmijë)

Jonuzi i moshuar, para daljes në pension, punonte në Kombinatin *Trepça/Trepča*. Ai ka jetuar me djemtë, Mehmetin dhe Jetullahun, si dhe me familjet e tyre në **Vidishiq/Vidušić.** Që nga viti 1998, Januzi jetonte te Jetullahu. Më 15.09.1998, forcat serbe e rrethuan fshatin, kështu që Jetullahu me familje dhe vendasit u larguan nga fshati gjatë natës. Januzi dhe disa fshatarë më të moshuar qëndruan në fshat. Ata u strehuan në bunkerin e UÇK-së, jo shumë larg nga shtëpia e Jetullahut. Trupin e pajetë të Januzit e kanë gjetur ushtarët e UÇK-së më **16.09.1998**, pas tërheqjes së forcave serbe. Trupi i tij ishte jo larg nga shtëpia e Jetullahut. Të nesërmen, e kanë varrosur në varrezat e fshatit. Pranë varrit e vendosën një dërrasë të vogël të gdhendur me emrin e Januzit. Ai edhe sot pushon në të njëjtin vend.

Burimi: deklarata J.S, FDH-17409.

Bahrije (Asllan) Nuha

(1968, shqiptare nga Melenica/Meljenica, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica)

Bahrija ishte e paralizuar dhe kishte pengesa në të folur. Në datën 15.09.1998, me rastin e rrethimit të fshatit nga forcat serbe, banorët u zhvendosën në fshatin Zabërgjë/ Zabrđe. Bahrija ishte me prindërit e saj. Të nesërmen, më **16.09.1998,** familja e Bahrijes u nis për në fshatin Deda/Dedinje, ndërsa Bahrijen e strehuan te një vendas, Sokoli, i cili i kishte dy vajza të paralizuara. Së shpejti në **Zabërgjë/Zabrđe** erdhi axha i Bahrijës, Enveri. Në shtëpinë e Sokolit e ka gjetur vetëm Bahrijen. Derisa forcat serbe ishin duke u afruar, Enveri arriti që ta nxirrte atë nga shtëpia dhe ta bartte deri në pyll. Bahrija ishte shumë e frikësuar dhe filloi të bërtiste. Forcat serbe po i afroheshin pyllit. Atëherë Enveri e braktisi Bahrijen dhe iku me vrap. Pas disa ditësh, Enveri u kthye në Zabërgjë/Zabrđe. Atje mësoi se një hoxhë dhe një ushtar i UÇK-së e kanë gjetur në pyll trupin e pajetë dhe të përdhosur të Bahrijes, të cilën e kanë varrosur më 20.09.1998, në varrezat në Zabërgjë/Zabrđe.

Burimet: deklarata E.N, FDH-29927; KMDLNJ, *Buletini*, num.10, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-8207; *Albanian Women, Missing since Serb Offensive on Her Village, Found Dead*, pasqyra e lajmeve, KIC, 05.10.1998, HLC-29724.

Sadullah (Selman) Dibrani

(25.10.1951, shqiptar nga Vaganica, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, axhustator, dhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Avni (Jetullah) Dibrani

(14.02.1977, shqiptar nga Vaganica, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, punëtor ndërtimtarie, pjesëtar i UÇK-së)

Sadullahu para lufte punonte si axhustator. Në afërsi të shtëpisë së tij jetonte i vëllai Selmani me familjen e vet. Djali më i madh i Jetullahut, Avniu, jetonte dhe punonte në Gjermani. Në fund të dhjetorit të vitit 1997, Avniu u kthye në Kosovë. Në qershor të vitit 1998, Avniu, i ati dhe axha i tij